

FOTO/Ishte gati për të vrarë bashkëshorten, policia ndërhyr në kohë, parandalohet krimi në Shkodër

28 Shtator, 2019

Share

Tweet

Share

Share



Policia ka parandaluar një ngjarje të rëndë kriminale në familje. Burime zyrtare nga policia informojnë se një burrë ka kanosur me armë dhe ka dhunuar fizikisht bashkëshorten.

Ngjarja ka ndodhur në Shkodër, ndërsa policia sapo ka bere arrestimin ka sekuestruar në cilësinë e provës materiale një armë zjarri kallashnikov pa leje.

"Specialistët për parandalimin dhe Hetimin e Krimeve në Komisariatit e Policisë Shkodër arrestuan shtetasin:

– Z. Ç., 29 vjeç, banues në fshatin Rragam/Shkodër.

Shërbimet e Policisë Shkodër, pas marrjes së njoftimit se në fshatin Rragam, Shkodër një shtetas po kanoste me armë zjarri dhe po dhunonte fizikisht në banesë bashkëshorten, kanë shkuar menjëherë në adresën e dhënë. Shtetasi Z. Ç., kur ka parë shërbimet e Policisë, ka lënë armën e zjarrit në banesë dhe është larguar në drejtim të pyllit, por është kapur pas disa orë ndjekjesh nga shërbimet e Policisë.

Në cilësinë e provës materiale u sekuestrua arma e zjarrit kallashnikov dhe në përfundim të veprimeve të para hetimore u bë arrestimi i shtetasis Z. Ç., për veprat penale "Kanosje", "Dhunë në familje" dhe "Mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit".

Materialet procedurale i kaluan për veprime të mëtejshme Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër",- informon policia.



Për t'u bërë pjesë e grupit të "DRONI.al - Agjencia Kombëtare e Lajmeve" mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet.


KOMUNITETI DRONI.AL: <https://www.facebook.com/groups/426976918158037/>

Share


Tweet

Share


Share



Datum smrti je moguće
predvideti po datumu
rođenja: veoma prosto...



Hirurg: "Ljudi dožive
SRČANI I MOŽDANI UDAR
ako svako jutro ne..."



Datum smrti je moguće
predvideti po datumu
rođenja: veoma prosto...



Djevojka koja je smršala 34
kg srušila internet svojim
receptom!